



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES
Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 2223 10
e-mail:info@durres.gov.al

THIRRJE PËR TRAJNER

Lënda : Përshkrimi i termave të referencës për përzgjedhjen e trainerëve që do të trajnojnë stafin e Bashkisë për integrimin gjinor dhe buxhetimin gjinor me pjesëmarrje.

Afati i fundit i aplikimit datë 26 Nëntor 2013/Ora 16.00

TERMAT E REFERENCËS

Bashkia e Durrësit kërkon kandidatë të kualifikuar për të përzgjedhur/kontraktuar dy trainere/ë si më poshtë:

Titulli i Pozicionit: Trainerë në trajnimin për integrimin gjinor dhe buxhetimin gjinor me pjesëmarrje (GM&GRB).

Titulli i Projektit : Zhvillimi i një modeli të qendrueshëm të sistemit të Reagimit të Koordinuar të Komunitetit kundër Dhunës në Familje në Durrës, shtrirja e këtij modeli në disa nga zonat sub-urbane dhe rurale përreth Durrësit, , si dhe integrimi gjinor në planet e zhvillimit lokal”.

Kohëzgjatja e punës : 3 ditë pune brenda periudhës nga data e firmosjes se kontrates.

Arsimi i kërkuar: Diplomë universitare në një nga fushat e mëposhtme: Ekonomi, Sociologji, Punë Sociale. Masteri ose një diplomë e avancuar universitare konsiderohet si përparësi.

Përvojë pune: Të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e trajnimeve në çështjet gjinore, fokusuar kryesisht tek integrimi gjinor dhe buxhetimi gjinor me pjesëmarrje. Eksperiencat me trajnime të kësaj natyre të zhvilluara në nivel vendor, konsiderohen përparësi

Përshkrimi:

Bashkia e Durrësit ka hedhur një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të hartimit të dokumentave, politikave dhe planeve të duhura për zhvillimin socio-ekonomik të territorit që mbulon. Një vëmendje e vecantë në hartimin e këtyre dokumentave iu është kushtuar edhe çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Në këtë kuadër, ka lindur si nevojë organizimi i një trajnimit specifik me stafin e Bashkisë në lidhje me integrimin gjinor në politikën dhe planet vendore, si edhe njohurive bazë për hedhjen e hapave të duhur përpara i takon procesit të buxhetimit gjinor me pjesëmarrje. Për të përmbushur këtë nevojë, Bashkia e Durrësit po kërkon të përzgjedhë dhe kontraktojë dy trajnerë me eksperiencë në këtë fushë, të cilat/ët duhet të kenë kualifikimin e përcaktuar më sipër dhe eksperiencë në lidhje me organizimin e trajnimeve të kësaj natyre në nivel vendor.

Qëllimi dhe objektivat e trajnimit

Objektivi i përgjithshëm i trainimit do të jetë ofrimi i dijeve dhe përforsimi i shprehive të integritit gjinor nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve për buxhetimin gjinor mes stafit të Bashkisë

Në mënyrë specifike, trainimi mbi integrimin gjinor dhe buxhetimin gjinor do të synojë:

- Të përforcojë dijet dhe qëndrimet e duhura të nevojshme për të ndërmarrë integrimin gjinor brenda proceseve vendore të politikave;
- Të pajisë pjesëmarrësit me dijet e duhura mbi mënyrën se si të integrohet përkatësia gjinore në proceset e politikave dhe në buxhetet e tyre përkatëse;
- Të ndërtojë veprimtaritë e duhura në lidhje me skicimin e nevojave për barazinë gjinore dhe të zhvillojë fushat për punë pasuese mbi integrimin gjinor (përfshirë dhe Buxhetimin Gjinor);

KUALIFIKIME: Trainerët e përzgjedhur duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Ekonomi, Sociologji, apo Punë Sociale. Diplomë e avancuar universitare në këtë fushë përbën vlerë të shtuar;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në fushën e trajnimeve mbi çështje të integritit gjinor dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje;
- Njohuri të vërtetuara dhe përvojë në lidhje me legjislacionin aktual në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, si edhe njohuri mbi procesin e buxhetimit në Shqipëri. Eksperiencë në ofrimin e trajnimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve në nivel vendor.

Kohëzgjatja: Detyra e moderatorit do të jetë tre dite dhe duhet të zhvillohet brenda periudhes së përcaktuar në kontratë. Trainerët do të kontraktohen për tre ditë pune brenda kësaj periudhe kohore, sipas të cilave ½ ditë për përgatitjen, 2 ditë për zhvillimin e trajnimit si dhe ½ ditë për vlerësimin dhe raportimin në kuadër të trajnimit të zhvilluar.

AFATI PËR APLIKIME:

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 26 Nëntor 2013, ora 16.00.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Një letër për shprehje interesi (Aneks 1)
- Curriculum Vitae
- Kopje të dokumentacionit që provon arsimimin dhe kualifikimin e kandidates/it (pas përzgjedhjes, dokumentacioni i dorëzuar gjatë aplikimit do të duhet të dorëzohet i noterizuar)
- Një draft program trajnimi ku të specifikohen çështjet kryesore që mendohet të trajtohen në dy ditë trajnimi, bazuar në qëllimin dhe objektivat e cituara më sipër.
- Një propozim financiar (totali i kërkuar për tre ditë pune, sipas kritereve të mësipërme, duke detajuar fee për ditë pune, kosto transporti – nëse ka, etj).